

S T A T U T I
I SHOQERISE TREGTARE
"MATRIX" SH.P.K.

Sot më datë 15/04/2024 në Tiranë ishte prezent personalisht ortaku themelues:

Z. Neraida Taushani shtetase shqipëtare, lindur ne Shijak, Durrës me 14.07. 1983, dhe banuese në Rr "Osman Myderrizi", Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar nga karta e identitetit me nr. I35714060.

Ka vendosur të themelojë shoqerinë "Matrix" Sh.p.k dhe ka vendosur te miratoje dhe të nënshkruajë statutin e shoqërisë në përputhje me ligjin e ri që rregullon organizimin e shoqërive tregtare me termë si me poshtë:

I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME


Shoqëria Tregtare "Matrix" Sh.p.k. rregullon pozitën e saj juridike, marredhëni e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marredhëni me të punësuarit, duke u bazuar **në ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 i ndryshuar** "Per Tregtarët dhe Shoqërët Tregtare" dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marredhëni e Shoqëritë Tregtare.

NENI 1

Objekti i veprimtarisë


Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë por duke mos u kufizuar në:

- Kryerja e konsulences ligjore ne fusha te ndryshme te se drejtes si dhe cdo veprimtari tjeter te natyres financiare e tregtare per permbushjen e aktivitetit te shoqerise, ne perputhje me Ligjin Shqiptar.
- Konsulence financiare, ne menaxhim dhe organizim, zhvillim biznesi. Asistence ne ceshtje ligjore dhe administrative, ne marredhenie me administraten publike me qellim kerkimin dhe leshimin e vertetimeve, dokumentave, lejeve, licensave, autorizimeve, koncesioneve dhe akteve te tjera te nevojshme, si dhe sherbime ne lehtesimin e logistikës per ushtrimin e aktivitetit te te asistuarve, etj.
- Funksionim si shoqeri one stop shop duke ofruar asistence ne aktivitetin e perditeshem te shoqerive, blerje shitje dhe qera te pasurive te patundshme, cdo veprimtari te lejuar nga ligji dhe/ose pjesemarrjen ne cdo aktivitet te ligjshemqe mund te kryeje një shoqeri me perjegjesi te kufizuar, e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar, mund te ndryshohet her pas here.
- Shoqeria mund te kete pjesemarrje ne shoqeri te tjera. Organizim eventesh biznesi, konferanca, axhende takimesh, sherime ne kerkim dhe studim tregu,



- sherbim kontabiliteti, sherbime marketingu, sherbime topografike dhe gjeodezike, projektimi, ndertime civile dhe industriale.
- Shitje-blerje materiale ndertimi, import-export. Supervizim punimesh ne ndertim, menaxhim dhe drejtim i aktivitetit te shoqerive te tjera.
 - Shoqeria ka per objekt paresor te saj ofrimin e konsulences, kryesisht ligjore, nepermjet keshillimit ligjor per çeshtje te ndryshme, perqatitjes se kerkese p~~ro~~adive ose te kerkesave gjate procedimit civil, dhe administrativ, penal si dhe te kerkesave ankimore, rekurseve kunder vendimeve gjyquesore, arbitrazhit ose te organeve te Administrates Publike; perqatitjes se ankesave dhe kerkesave te personave fizik apo shoqerive te ndryshme tregtare vendase dhe te huaja, perpilimit te akteve qe i nenshtrohen veprimtarive noteriale, hartimit te kont~~r~~ratave e te marreveshjeve, si dhe te çdo dokumenti tjeter qe sjell ose synon te sjelle~~s~~ pasoja juridike;
 - Keshillimit e asistences ligjore, perpilimit te akteve, krijimin, regjistrimin e shoqerive tregtare ose personave te tjere juridike, asistences ligjore ne vazhdimesi te aktivitetit te tyre si dhe marredheniet e tyre me personat fizike dhe juridik per 2 arritjen e marreveshjeve tregtare si brenda dhe jashte vendit.
 - Shoqeria mund te ofroje edhe konsulencia te tjera te cilat ndihmojne objektin~~u~~ me siper.
 - Shoqeria mund te ofroje cdo sherbim konsulence, pa kufizim, qe ka te beje n~~e~~ njohjen apo zbatimi apo hartimin e ligjit. Shoqeria mund te kryeje edhe akti vitete qe kane te bejne me hartimin, zbatimin, krijimin dhe asistencen te çdo produkti te lidhur me fushen juridike dhe akademike, botime te çdo lloji, si per vete shoqerine, ashtu edhe per te trete, dhe per zhvillim e aktiviteteve tregtare, industriale te çdo lloji,blerjen, shitjen, shkembimin, qiramarrjen, menaxhim in, administrimin e pronave te veta te luajtshme e te paluajtshme, e te te treteve, si dhe zhvillimin e te gjitha aktiviteteteve te lidhura ne menyre direkte ose indirekte me aktivitetin e pronave te veta ne perqjithesi.
 - Shoqeria mund te kryeje edhe aktivitet per llogari te te treteve, lidhur me aktivitetet me siper.
 - Shoqeria do te mund te bleje, jo ne kuader te aktivitetit te saj paresor, pjesemarrje aksionare apo jo aksionare ne shoqeri te tjera, ente, konsortiume, te themeluara apo ne themelim. te cilat kane objekt te ngjashem apo sidoqofte te nderlidhur apo plotesues te objektit te saj, apo sidoqofte ne funksion te arrijes se qellimeve te shoqerise.
 - Shoqeria, per efekt te realizimit te objektit te saj, gjithashtu, do te mund te zhvilloje aktivitete ndertimi, shitblerjeje dhe menaxhimi te pasurive te paluajtshme.
 - Shoqeria do te mund te kryeje çdo veprim qe ka te beje me pasurine e luajtshme, te paluajtshme apo financiare qe kane lidhje me objektin e shoqerise, perfshire ketu, por pa u limituar ne te, nenshkrimin e marrjes se kredive me institucionet te autorizuara nga ligji si dhe me shoqeri dhe ndermarrje private. Me ne perqjithesi, shoqeria do te mund te kryeje cdo aktivitet te nevojshem apo te dobishem per perm bushjen e qellimeve te shoqerise.
 - Shoqeria nuk mund te zhvilloje aktivitet te qe shkel ligjin shqiptar ne fuqi

- Ndërtime, rikonstruksione, projektme te ndryshme dhe mirëmbajtje të gjitha fushave dhe të gjitha llojeve, veprimitari industriale dhe tregtare, investime dhe financime në të gjitha fushat, veprimitari importi eksporti, konsulencë dhe ndërmjetësime të të gjitha llojeve, veprimitari transportuese, marrje dhe dhënie me qera të pasurive dhe objekteve të ndryshme, veprimitari studimore projektuese dhe supervizioni të ndryshme.
- Veprimitari ndërtimore, rikonstruksione dhe mirembajtje në fushën e ndërtimit, përfshirë ndërtime civile, rrugë ura, porte, vepra arti, tunele, ndërtime ushtarake, aeroporte, ndërtime industriale, objekte kulti, kulturore, sportive, spitale, hotele, banesa, ndërtime hidroteknike dhe turistike, kampingje, parqe rekreative, shtëpi pushimi, palestra, kënde sportive etj. Veprimitari prodhuese të materialeve të ndërtimit, paisje dhe të makineve, përfshire prodhimin e inerteve, rërë, zhavor, konglomerate bituminoze, parafabrikate, konstruksione ndërtimore betonarme, druri metalike, llaçë betone te markave të ndryshme, prodhime gurë gelqere e çakull.
- Veprimitari transportuese ku përfshihet transporti nacional internacionali i mallrave dhe i njerzve për vete dhe të tretë, për import eksport. Ushtrimi i veprimtarise ne fushen turistike, hapje te agjensive turistike te udhetimit per transportin tokesor, detar dhe ajror.
- Veprimitari ne fushen e kembimit valutor dhe argjendari.
- Tregtim i te gjitha llojeve te pajisjeve elektronike dhe ato informatike. Import-Eksport, tregtimi me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshëm te pajisjeve elektronike. Projektim, zbatime, kolaudime, supervizione ne fushat elektronike. Projektim, implementim, mirembajtje dhe administrim te platformave Software, Hardware dhe te pajisjeve te sigurise. Riparime te pjeseve te pajisjeve elektronike. Hartim projektesh, dhenie asistence teknike, tregtim te materialeve dhe imputeve te ndryshme te pajisjeve elektronike. Instalim sistemesh te ndryshme elektronike.
- Veprimitari eksportuese dhe importuese, ku përfshihet eksporti i lendeve të para dhe i mallrave të përpunuara, si dhe importimi i të gjitha llojeve të mallrave dhe materialeve. Veprimitari tregtare, përfshirë tregtimin me shumicë dhe pakicë të mallrave ushqimore dhe industriale, ndërtimore, elektrike, elektronike bujqësore blektorale, tekstile, hidrosanitare, makineri dhe aparatura, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme. Veprimitari komisionere, konsulencë në fusha të ndryshme, ndërmjetësime, koperime, përfaqësime dhe tranzitime, shërbime të llojeve të ndryshme. Veprimitari studimore dhe projektuese në fusha të ndryshme të ekonomise, ndërtimore, mekanike, elektrike etj. Veprimitari investuese dhe financuese ku shoqëria do të përdorë për këtë qëllim fonde të saj si dhe fonde të institucioneve financiare dhe bankare vendase dhe të huaja, private dhe publike. Marrje dhe dhënie me qira objekte dhe mjete, paisje dhe zyra, ambiente te ndryshme, pasuri të luajshme dhe të paluajtshme. Veprimitari te ndryshme agrare dhe blektorale.



- Gjithashtu, per te realizuar objektivat e saj, shoqeria mund te ndermarre e te zhvilloje edhe cdo lloj aktiviteti tjeter te ligjshem ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe qe siguron te ardhura dhe fitime te ligjshme.
- Objekti i shoqerise mund te zgjerohet apo zvogelohet ne varesi te interesave te shoqerise dhe ne baze te vendimit te asamblese se pergjithshme te ortakeve.

NENI 2

Emri dhe selia e Shoqërisë

Shoqëria është Person Juridik Privat.

Shoqëria do të paraqitet në qarkullim me emërtimin e saj "Matrix" Sh.p.k.

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rr e "Abdyl Frasherri" Hyrja 1, Kat 2, Tiranë, Shqipëri.

NENI 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe ka filluar me regjistrimin e shoqerise në Regjistrin Tregtar. Ortakët e Shoqërisë mund te vendosin kufizimin e afatit te veprimtarise dhe me pas zgjatjen e saj një apo disa here, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 4

Regjimi Juridik i Shoqërise

Shoqëria është një shoqeri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.).

Veprimitaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit së Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi.


Me vendim të Asamblesë së Pergjithshme, Shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik te saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të janë në fuqi si dhe në perputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse.

Shoqëria gjëzon personalitet juridik nga data e rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar. Shoqëria ka vulën e saj.

II. TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

NENI 5

Përgjegjësia e Ortakëve



Kapitali i shoqerisë është në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lek, i ndarë ~~me~~ 1(një) kuotë me vlerë nominale të një kuote prej 100.000 (njëqind mijë) lek.

Znj. Neraida Taushani zotëron 1 kuotë të kapitalit themeltar, pra 100 % t~~ë~~ tij në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lek.

Kapitali themeltar është investuar nga ortaku në total.

NENI 8

Pronësia mbi kuotat

Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqerisë;
- shit-blerjes;
- trashëgimise;
- dhurimit;
- në çdo mënyrë tjeter të parashikuar në ligj.

NENI 9

Fitimi ose transferimi i kuotave

Pavarësisht nga mënyra e fitimit apo kalimit të kuotave, është i nevojshëm mi~~r~~ratimi i Asamblesë së Përgjithshme te Ortakëve. Ne çdo rast, ortakët e shoqerisë gëzojnë të drejtën e parablerjes.

Transferimet e kapitalit themeltar duhet të vërtetohen sipas ligjit, ndryshe janë të pavlefshme.

NENI 10

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme.

Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqerisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve.

Asambleja e Përgjithshme, vendos për zvogëlimin e kapitalit të Shoqerisë.


Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kane dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit.

NENI 11

Fondet rezerve

Shoqeria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojate saj ekonomike.

Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerjen e detyrimeve gjate veprimitarisë së saj.



NENI 12

Përdorimi i të ardhurave neto

E ardhura **neto** që rezulton mbasi zbriten shpenzimet e bëra per kryerjen e cdo lloj aktiviteti **nga** zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që rritin **kreditin** për investime, pagat e shpërblimet, përdorët nga Ortakët, sipas sellimeve të tyre.

NENI 13

Bilanci

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakëve ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqërisë.

Bilanci vjetor paraqitet brenda dates 31 Mars të vitit pasardhës.

Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

NENI 14

Plani finanziar

Plani finanziar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri.

Shkëmbimi i monedhës shqiptare me ate të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

NENI 15

Shpërndarja e fitimeve

Ortakët kane të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.

Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

NENI 16

Kufizimi i shpërndarjeve te fitimeve

Shoqëria do te shpërndajë fitimet ortakëve ne cdo fund te vitit finanziar, pas miratimit të bilancit nga Asambleja e Ortakeve, vetëm nëse pas pagimit të dividendifit:

- aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme per të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratori / Administratoret lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividentëve përbush kërkkesat e mësipërme.



Kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

Administratori, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividentëve të shpërndarë.

Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividentëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kane pasur dijeni për gjendjen e paaftësise paguese të shoqërisë, ose në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund tëmos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

IV. ORGANET E SHOQERISE

NENI 17

Asambleja e Përgjithshme


Organi themelor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime për:

1. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
2. ndryshimet e statutit;
3. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
4. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar;
5. percaktimin e shperblimeve per administratoret, likuiduesit dhe ekspertertë kontabel te autorizuar;
6. mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, perfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
7. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
8. zmadhimin dhe zvogëllmin e kapitalit;
9. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
10. përfaqesimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
11. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
12. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
13. çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

NENI 18

Mbledhja e Asamblese se Përgjithshme



Asambleja e Pergjithshme mblidhet sa here që mbledhja është e nevojshme p~~o~~er t~~e~~ mbrojtur interesat e shoqërisë.

Mbledhja e asamblesë së per gjithshme thirret t~~e~~ paktën një here n~~e~~ vit. Asamb~~le~~je e per gjithshme thirret nga administratorët apo ortakët t~~e~~ cilët përfaqësojnë t~~e~~ p~~a~~kten 5% te totalit t~~e~~ votave n~~e~~ asamblenë e per gjithshme t~~e~~ shoqërisë.

Asambleja e per gjithshme thirret n~~e~~se:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve t~~e~~ ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqerise nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve n~~e~~ vazhdim.
- shoqeria propozon t~~e~~ shesë apo t~~e~~ disponojë n~~e~~ mënyrë tjeter aktive, t~~e~~ cilat kane një vlerë me t~~e~~ lartë se 5 per qind t~~e~~ aseteve t~~e~~ shoqërisë, q~~e~~ rezulton n~~e~~ pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve t~~e~~ para pas regjistrimit t~~e~~ saj, propozon t~~e~~ blej ë nga një ortak pasuri, q~~e~~ kane vlerë me t~~e~~ lartë se 5 per qind t~~e~~ aseteve t~~e~~ shoqërisë, q~~e~~ rezulton n~~e~~ pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

NENI 19

Thirrja e Asamblesë se Pergjithshme

Asambleja e per gjithshme thirret n~~e~~përmjet një njoftirni me shkresë ose, me nj~~o~~ftim n~~e~~përmjet postës elektronike.

Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet t~~e~~ permbarë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet t~~e~~ gjithe ortakëve, jo me vonë se 15 ditë perpara dates së parashikuar per mbledhjen e asamblesë.


Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si me sipër, ajo mund t~~e~~ marrë vendime t~~e~~ vlefshme vetëm n~~e~~se t~~e~~ gjithë ortakët jane dakord, per t~~e~~ marrë vendime, pavarësisht parregullsise.

NENI 20

Kuorumi i nevojshëm dhe vendim-marrja

Ne rastin e marrjes se vendimeve, q~~e~~ kërkojnë një shumicë t~~e~~ zakonshme, asambleja e per gjithshme mund t~~e~~ marrë vendime te vlefshme vetëm n~~e~~se marrin pjesë ortakët me t~~e~~ drejtë vote, q~~e~~ zotërojnë me shumë se 30 per qind t~~e~~ kuotave.

Ne rastin kur asambleja e per gjithshme duhet t~~e~~ vendosë per ceshtje, t~~e~~ cilat kërkojnë shumicë t~~e~~ kualifikuar, ajo mund t~~e~~ marrë vendime te vlefshme vetëm n~~e~~se ortakët q~~e~~ zotërojnë me shumë se gjysmen e numrit total t~~e~~ votave Jane t~~e~~ pranishem personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike. N~~e~~se asambleja e per gjithshme nuk mund t~~e~~ mblidhet per shkak t~~e~~ mungesës së kuorumi t~~e~~ përmendur me sipër, asambleja mblidhet perseri jo me vonë se 30 ditë, me t~~e~~ njëtin rend dite.



Asambleja e per gjithshme vendos me tre të katertat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelirnin e kapitalit të regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Per ceshtjet e tjera, asambleja e per gjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

Ortakët, që nuk janë te pranishëm, mundësinë e pjesemarrjes në mbledhjen e asamblesë së per gjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, perfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Ortaku, që pengohet të ushtrojë te drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdheroje ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasoje e cenimit te ketyre te drejtave.

NENI 21

Proçesverbali i mbledhjes se asamblesë

Të gjitha vendimet e asamblesë së per gjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.

Administratorët per gjigjen per ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë se per gjithshme.

Procesverbali duhet të përbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes se asamblesë së per gjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

V. ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 22

Administratoret


Asambleja e per gjithshme emëron një ose deri ne tre persona fizik si administratorë të shoqerise.

Afati i emëritimit, nuk mund të jetë me i gjatë se 5 vjet, me të drejtë riparteritjeje.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.

Administratori i Shoqërisë "Matrix" Sh.p.k, është Znj. Neraida Taushani , shtetase shqipëtare, lindur ne Shijak, Durrës me 14.07.1983, dhe banuese në Rr "Osman Myderrizi", Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar nga karta e identitetit me nr. I35714060Q e cila eshte zgjedhur për një periudhe 5 vjecare 15.04.2024 - 14.04.2029, me të drejtë riparteritje.



Shoqëria do të përfaqësohet përpara cdo organi administrativ, gjyqësor, apo ç'do entiteti tjeter publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 23

Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve

Administratorët kane të drejtë e detyrohen të:

1. Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. Përfaqesojne shoqërinë tregtare;
3. Kujdesen per mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqerise;
4. Pergatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet per shpemdarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme per miratim;
5. Krijojnë një sistem paralajmerimi në kohën e duhur per rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencën e shoqërise;
6. Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënrat e detyrueshme te shoqërisë, sic parashikohet në ligjin per Qendren Kombëtare të Regjistrimit;
7. Raportojne përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi te veçantë per veprimtarinë e shoqerise tregtare;
8. Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara ne ligj dhe në statut.
9. Therrasin asamblenë e përgjithshme kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit te saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kane vlerë me të rritë se 5 per qind të aseteve të shoqerise, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.


Kompetencat, te drejtat dhe detyrimet e Administratorit do te percaktohen ne aktin e emerimit te tij nga Asambleja e Përgjithshme.

Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, mund të parashikojne ndryshe.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të perjashtojne apo kufizojnë këtë të drejtë.

NENI 24

Shpërblimi i administratorëve



Shpërblimit baze të administratoreve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë perqindje në fitim ose te ngjashme. Shpërblimet e administratorëve percaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së per gjithshme.

Shpërblimi, duhet të jetë i pershtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërise.

Nëse shoqeria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit te administratorëve në masën e pershtatshme. Kriteret e shperblirnit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqerise tregtare publikohën së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 25

Ekspertët Kontabël

Shoqëria cakton ekspert kontabël per cdo vit finanziar kur jemi përparrë rasteve të percaktuara në ligj. Emërimin e tyre e ben Mbledhja e Asamblesë së Pergjithshme. Ekspertet kontabël mbajnë pergjegjesi per mbajtjen e rregullt te të gjithe dokumentacionit të Shoqërisë.

Ata përgjigjen per dëmet që i vijnë Shoqerise nga mbajtja e parregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

Nuk mund të ngarkohen me detyren e ekspertit, themeluesi, administratori, personat që jane gjini e krushqi me ata deri në shkallën e katërt.

VI. MARREDHENIET E PUNES

NENI 26

Marredheniet e punes

Marredheniet e punës në Shoqeri rregullohen sipas dispozitave te Aktit të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.

Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontrates individuale të punës midis Shoqërisë e të punësuarve.

NENI 27

Pergjegjesite e te punesuarve

Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativ janë pergjegjës per dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë per faj të tyre dhe përgjigjen para saj civilisht.

VII. PRISHJA E SHOQERISE. LIKUJDIMI

NENI 28

Prishja e shoqerise



Kjo Shoqeri do të prishet në rastet kur:

1. merr vendim Asambleja e Pergjithshme;
2. hapen procedurat e falimentimit;
3. nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në perputhje me piken 3 te nenit 43 të ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombëtare të Regjistrimit";
4. merret një vendim gjykate.

Prishja e shoqërise regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qëndrës Kombëtare, të Regjistrimit nga Administratorët.

NENI 29

Likuidimi i shoqërise

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me perjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e per gjithshme. Nëse asambleja e per gjithshme nuk merr një vendim per emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per të caktuar një likuidues.

Çdo person i interesuar, ka të drejtë t'i kërkojë gjykates zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakeve, nëse paraqet arsyet e mjaftueshme per të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërise mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si me sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e calimit të likuiduesit.

Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqeria tregtare prishet me vendim gjykate. Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat per emërimin e tyre.

Administratorët e shoqërise i njoftojne per regjistrim, Qendres Kornbëta re të Regjistrimit të dhënët e likuiduesve te pare dhe tagrat e tyre, per te perfaqesuar shoqerine, se bashku me dokumentet perkatese. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre.


Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendres Kombetare të Regjistrimit per regjistrim çdo ndryshim per identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqesimit. Emërimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet ex officio, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqerise aksionare ndiqet nga shëniimi "në likuidim".

Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqerise per të depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit te tij.

NENI 30

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërise, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasuriye të



shoqerisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhén e referimit, sipas ~~1~~ nenit 605 të Kodit Civil.

Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, per mbylljen e një veprimi të paperfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejne se pasuria e shoqërise tregtare, perfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme per pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojn procedurën e likuidimit e t'i kërkojne gjykates përkatese nisjen e procedurave të falimentimit.

NENI 31

Bilancet

Likuiduesi pergatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në castin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc perfundimtar në çastin e mbylljes së ketyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat me shumë se një vit, likuiduesi pergatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Asambleja e Pergjithshme.

NENI 32

Shperndarja e aktiveve

Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shperndan ortakëve apo aksionarëve aktivet e mbetur, sipas të drejtave që ata kane në ndarjen e fitimeve, me perjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference.

Pasuritë, që i jane dhëne shoqërise me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve apo aksionarëve.

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendren Kombëtare të Regjistrimit per përfundimin e likuidimit dhe kërkon cregjistrimin e shoqërisë.

VIII. DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 33

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit te Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 34

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimi sht në kete Statut do të rregullohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me te në fuqi në Republiken e Shqiperise.

ORTAKU

Neraida Taushani

